

Studim mbi ndikimin e Ligjit Kundër Krimin të Organizuar dhe atij për Konfiskimin e Pasurisë së Fituar në Mënyrë të Paligjshme në luftën kundër korrupsionit

“MILIONAT E PALIGJSHME”

parandalimi dhe luftimi

PERSONELI

Ismet KRYEZIU - Drejtor Ekzekutiv

email: ikryeziu@kdi-kosova.org

Vjollca VOGËL - Menaxhere e administratës dhe financave

email: vjollca@kdi-kosova.org

Leonora CIKAJ - Asistente për administratë dhe financa

email: lcikaj@kdi-kosova.org

Donjeta DRESHAJ - Asistente për administratë dhe financa

email: ddreshaj@kdi-kosova.org

Arsim Gjinovci - IT & Design

email: agjinovci@kdi-kosova.org

**PROGRAMI: DEMOKRATIZIMI DHE
PRAKTIKAT PARLAMENTARE**

Driton SELMANAJ - Menaxher i programit

email: dselmanaj@kdi-kosova.org

Isuf ZEJNA - Asistent i projektit

email: izejna@kdi-kosova.org

**PROGRAMI: QEVERISJA LOKALE DHE
PJESËMARRJA QYTETARE**

Kreshnik BASHA - Koordinator

email: kbasha@kdi-kosova.org

NaimCAHANAJ - Koordinator

email: ncahanaj@kdi-kosova.org

PROGRAMI: TRANSPARENCA DHEANTIKORRUPSIONI

Merita MUSTAFA - Menagjere e programit

email: mmustafa@kdi-kosova.org

Enis XHEMAILI - Kryesues i hulumtimit

email: exhemaili@kdi-kosova.org

Besnik RAMADANAJ - Asistent i projektit

email: bramadanaj@kdi-kosova.org

Natyra KASUMAJ - Koordinatore

email: nkasumaj@kdi-kosova.org

PROGRAMI: ZGJEDHJET E LIRA DHE TË DREJTA

Liridon SELMANI - Menaxher i programit

email: lselmani@kdi-kosova.org

Përmbajtja:

4

I. Lista e shkurtesave	5
II. Hyrje.....	6
III. Metodologjia	8
IV. Baza aktuale - ligjore në luftën kundër krimit të organizuar dhe konfiskimit të pasurisë së paligjshme	9
V. Niveli i krimit të organizuar në Kosovë	11
5.1 Narkokriminaliteti dhe intenziteti i tij në Kosovë	11
5.2 Trafikimi me qenie njerëzore me qëllim të detyrimit të prostitucionit	13
VI. Masat e ndërmarra për luftën kundër krimit të organizuar	14
6.1 Strategjia shtetërore e Republikës së Kosovës kundër krimit të organizuar, plani i veprimit 2009-2012	14
6.2 Kompetenca e veçantë e PSRK-së (Prokuroria speciale e Republikës së Kosovës) ..	15
VII. Mekanizmat tjerë institucional dhe përgjegjësitë e tyre në luftën kundër krimi të organizuar.....	15
VIII. Konfiskimi i dobive pasurore të fituara nga aktivitetet e paligjshme	17
IX. Veprimet e institucioneve në luftën kundër krimit të organizuar dhe pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme	19
9.1. Sfidat në implementimin e kompetencave të institucioneve	19
9.2 Veprimet që duhet ndërmirren nga institucionet kompetente në luftë kundërkrimit të organizuar	21
9.2a Policia e Kosovës	21
9.2b Drejtësia	22
9.2c Dogana	22
9.2d Shoqëria civile	23
X. Rekomandime	25
XI. Burimet	26

I. Shkurtesat

AKI	Agjencia e Kosovës për Inteligjencë
ART	Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
DK	Doganat e Kosovës
DKKO	Drejtoria Kundër Krimit të Organizuar
EULEX	Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimit të Ligjit në Kosovë
ICITAP	Programi për ndihmë ndërkombëtare në trajnim për hetime të krimit
ICO	Zyra Civile Ndërkombëtare
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KPiK	Këshilli Prokurorial i Kosovës
KPPK	Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës
KPPPK	Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale të Kosovës
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MD	Ministria e Drejtësisë
MEF	Ministria e Ekonomisë dhe Financave
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MSH	Ministria e Shëndetësisë
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
MTPT	Ministria e Transportit dhe Postë – Telekomunikacionit
OSBE	Organizata për Bashkëpunim dhe Siguri në Evropë
PK	Policia e Kosovës
QIF	Qendra e Inteligjencës Financiare
SECI	Iniciativa për Bashkëpunim Jug-Lindor
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
ZKM	Zyra e Kryeministrit
AKK	Agjencioni Kundër Korrupsionit
MJ	Ministria e Punëve të Jashtme

II. Hyrje

6

Politika në shtetet në tranzicion si shtete me demokraci të pakonsoliduar (ku bën pjesë edhe vendi ynë), përmes institucioneve, sistemeve dhe mekanizmave të tyre duhet të sigurojnë ndërtimin e të gjitha parakushteve të nevojshme për një hapësirë – ambient demokratik e të sigurt i cili do të garantojë dhe sigurojë realizimin e suksesshëm të gjitha kushteve natyrore jetësore për ekzistimin dhe jetesën e njerëzve. Sot nuk mund të mendohet një shoqëri demokratike pa vendosjen e organeve shtetërore të cilat në bazë të normave dhe rregullave juridike përgjithësisht të pranuar mbrojnë vlerat e saj. Problemi qëndror i politikës në shoqëritë demokratike është se si të ruhet niveli i proporcionalitetit në mes të sigurisë dhe lirisë, veçanërisht nga arsyeja se është shumë vështirë në shoqërinë moderne të ndërmerren masat e domosdoshme për siguri e stabilitet dhe në të njëjtën kohë të mbrohen të drejtat e pa tjetërsuara dhe liritë themelore të individit.

Krimi i organizuar, paraqet njërin ndër kërcënimet më komplekse për stabilitetin ekonomik, politik, social dhe sigurinë e shoqërisë në tranzicion. Format e shumëfishta të manifestimit të tij dhe prezenca gjithnjë e më e madhe e tij (krimit të organizuar) si dhe infiltrimi në shumë fusha, duke shfrytëzuar lëvizjet jo të dobishme në sferën shoqërore - ekonomike politike e sfera tjera, kjo dukuri është shndërruar në njërin ndër faktorët destabilizues kufizues dhe frenues të konsolidimit dhe zhvillimit të shoqërive në tranzicion, së këndejmi edhe të Kosovës¹.

Me forcimin e fuqisë ekonomike dhe mbulimin e disa fushave të caktuara dhe territoreve, organizatat kriminale gjithnjë e më shumë hyjnë në fushën e aplikimit të dhunës e korrupsionit, me qëllim themelor që të mos lejohen barrierat dhe pengesat tjera në legalizimin e profitit të arritur në mënyrë të kundërligjshme.

Po ashtu në rritjen e fuqisë ekonomike e politike të bartësve të krimit të organizuar, në masë të madhe ka ndikuar komunikimi i tyre apo, lidhja mbrojtëse të cilën e kanë me individët e institucioneve të ndryshme, me ç’rast korrupsioni është indi lidhës dhe mjet themelor i cili përcjellë zhvillimin e krimit të organizuar. Kjo simbiozë e tillë, shumë vështirë mund të shpëputet më vonë, natyrisht që zbulimi i lidhjes do të thotë komprometim i përfaqësuesve të lartpërmendur, kurse në anën tjetër do të alarmonte organet dhe shërbimet e sigurisë, pastaj institucionet tjera për ndërmarrjen e të gjitha masave dhe veprimeve ligjore në dispozicion në kundërvënie këtij lloji të krimit - krimit të organizuar.

Ndër format më të shprehura të krimit të organizuar në Kosovë, pa mëdyshje se janë narkokriminaliteti (në trajtën e vet më të shpesht të kontrabandimit me narkotikë) dhe trafikimi me qenie njerëzore (në trajtën e trafikimit të femrave) me qëllim të detyrimit në prostitucion. Edhe raportet e ndryshme regjionale dhe ndërkombëtare mbi Kosovën veçojnë këto dy forma të krimit të organizuar si më fitimprurëse të biznesit të kundërligjshëm kriminal.

¹ Konkluzione nga Punëtorja e KDI-së, organizuar në qershor 2011, luidhur me diskutimin dhe marrjen e përvojave më të mirë për luftimin e krimit të organizuar. Pjesëmarrës në punëtori kanë qenë edhe ekspertë të kriminalistikës

Nga ana tjetër pasurimi i njerëzve me theks të veçantë zyrtarëve të zgjedhur brenda një periudhe shumë të shkurtë kohore, paraqet një shqetësim mbi formën se si është fituar ajo pasuri e që në shumicën e rasteve aludohet në aktivitetet kriminale. Shqetësues është po ashtu fakti se autoritetet kompetente-ndjekëse prokuroriale dhe gjyqësore, pothuajse nuk kanë lëvizur fare në drejtim të zbatimit të dispozitave të Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale (sado që janë të pashtjelluara sa duhet) që kërkon konfiskimin e të mirave materiale të cilat janë fituar përmes aktiviteteve dhe veprimeve kriminale.

Prandaj, draftimi dhe miratimi i Ligjit kundër Krimit të Organizuar dhe Ligjit për Konfiskimin e Pasurisë së Fituar në Mënyrë të Paligjshme, ku do të specifikoheshin qartë të gjitha kompetencat dhe përgjegjësit e secilit institucion përgjegjës, është jo vetëm një detyrim që rrjedh nga prioriteti që duhet përcaktuar Kosova për të luftuar këto dukuri, por ajo rrjedh edhe nga nevoja e implementimit të detyrimeve që dalin nga strategjitë rajonale .

Këto dy ligje duhet të marrin përsipër të përcaktojnë prioritetet strategjike të luftës kundër krimit të organizuar dhe konfiskimit të pasurisë së paligjshme. Po ashtu duhet të përcaktojnë objektivat e të gjitha institucioneve që marrin detyrime si dhe të harmonizojë veprimet ndërinstitucionale për arritjen e objektivave të përcaktuara.

Instituti Demokratik i Kosovës këtë vit ka filluar avokimin për kompletimin e pakos ligjore antikorrupsion në Kosovë, me fokus luftimin e krimit të organizuar dhe konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme. Në kuadër të këtij projekti, janë duke u përgatitur analiza studimore, e krahasuese edhe me vendet e rajonit.

Në këtë punim KDI, në pjesën e konsiderueshme të saj, është përqëndruar tek baza ligjore aktuale në vend, pastaj niveli i krimit të organizuar, masat e ndërmarra për luftimin e kësaj dukurie, konfiskimi i pasurisë së paligjshme, etj.

KDI në muajt në vijim do të publikojë një analizë të veçantë, mbi shembujt dhe praktikën e vendeve të rajoni karshi këtyre fenomeneve, ku edhe do të ofrohen rekomandime dhe modalitet për institucionet e Kosovës në luftë kundër këtyre dukurive.

III. Metodologjia

8

Metodologjia e përdorur në këtë analizë bazohet në analizimin e legjislacionit aktual që prekin këto fusha, përfshirë Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale të Kosovës, si dhe raporte të tjera që institucioneve të rendit dhe të drejtësisë, sikurse edhe raporte të mekanizmave tjerë që funksionojnë në Kosovë, në kuadër të sundimit të ligjit. Në analizë po ashtu janë bërë edhe krahasime të përvojave të ndryshme. Po ashtu, janë analizuar të dhëna të raporteve të organeve të drejtësisë, si dhe janë përdorur edhe inpute të punëtorive të organizuara nga Instituti Demokratik i Kosovës.

Bazë e veçantë e marrjes së informatave kanë qenë edhe Gazeta Zyrtare, shërbimet gjyqësore, prokuroriale, policore, KPPK, OJQ-të, etj.

Për këtë analizë janë shfrytëzuar edhe raporte e statistika të institucioneve e mekanizmave vendore e ndërkombëtare.

IV. Baza aktuale - ligjore në luftën kundër krimit të organizuar dhe konfiskimit të pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme

Arsyetimet e autoriteteve të drejtësisë për ta luftuar krimin e organizuar, përfshirë edhe konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme, shpeshherë lidhen me mungesën e legjislacionit adekuat apo me konfuzitetin dhe paqartësinë e mjaftueshme të legjislacionit aktual në Kosovë. Në fakt, krahasuar me vendet tjera, në veçanti me ato të rajonit, Kosovës i mungojnë ligjet specifike që do t'i mundësonin një luftë efikase ndaj këtyre dukurive.

Ndonëse mungon zinxhiri i ligjeve specifike që mundësojnë luftimin e krimit të organizuar, megjithatë ka një bazë legjislative solide që e parasheh luftimin e kësaj dukurie, e cila domosdo duhet plotësuar. Gati të gjitha shtetet fqinje kanë ose kanë miratuar legjislacion shtesë ose kanë amendamentuar kodet penale, në mënyrë që të rregullojnë në mënyrë specifike çështjen e konfiskimit të pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme.

Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës (KPK) në fuqi, përkufizon “grupet e krimit të organizuara”, në nenin 274. Nocioni “krim i organizuar”, parasheh dënim me burg minimal nga 5 vjet e sipër (krijuesit apo menaxherët e grupit të krimit të organizuar rrezikojnë burgim minimal 7 deri në 20 vjet).

Krimi i organizuar, sipas shprehjeve strikte ligjore, ekziston kur dikush “kryen krim të rëndë si pjesë e një grupi të organizuar kriminal” (parag. 1 i nenit 274); kur aktivisht merr pjesë në aktivitete kriminale ose në aktivitet të tjera të një grupi kriminal të organizuar, duke e ditur se pjesëmarrja e tij do t'i kontribuojë kryerjes së krimeve të rënda nga grupi kriminal i organizuar” (parag. 2 i nenit 274); kur “organizon, formon, mbikëqyr, udhëheq apo drejton veprimet e ndonjë grupi kriminal të organizuar” (parag. 3 i nenit 274); apo, së fundmi, kur “kryen veprë penale nga paragrafi 2. i këtij neni, nëse veprimtaria e grupit të organizuar rezulton me vdekje” (parag. 4 i nenit 274).

Sipas po këtij neni, në paragrafin (7) krimi i organizuar përkufizohet si “krim i rëndë i kryer nga ndonjë grup i strukturuar për të përfituar drejtpërsëdrejti ose tërthorazi dobi pasurore a financiare” (nënparag. 1 i nenit 274)².

KPPK përcakton ekzistimin e krimit të organizuar ku përfshihen: mënyra e detyrimit (“dhunë, kërcënim për përdorimin e dhunës ose ndonjë mënyrë tjetër të detyrimit); lloji i detyrimit (“duke i premtuar dhuratë, apo ndonjë përfitim tjetër”) qëllimi i detyrimit (“për të nxitur personin tjetër të përmbahet nga dhënia e deklaratës ose për të dhënë deklaratë të rrejshme, ose të mos japë informacione të vërteta pranë organeve policore, prokurorit publik apo gjyqtarit”) dhe lidhja shkajkore midis veprimit dhe pasojës (“kur informacionet e tilla ndërliken me kryerjen e krimit të organizuar”).

Kushtetuta e Kosovës dhe KPPK parashikojnë se organet shtetërore, duke ushtruar mandatin ligjor të zbulimit (policia), ndjekjes (prokuroria) dhe dënimit (gjykata), specifikojnë: të pandehurit, periudhën inkriminuese, vendndodhjen, mënyrën e kryerjes dhe pasojat e shkaktuara, si dhe provojnë kryerjen e veprës penale të krimit të orga-

² Neni 274 I KPK (Kodi i përkohshëm penal i Kosovës).

nizuar që pason me shpalljen e fajësisë dhe përfundon me shqiptimin e sanksionit penal, duke justifikuar veprimet procedurale me prova materiale të pranueshme dhe të mjaftueshme ligjërisht.

Bazuar në praktikat e vendeve më me përvojë në luftimin e krimit të organizuar, janë të domosdoshme ligje adekuate që i përcaktojnë qartë përgjegjësitë e institucioneve si dhe i mundësojnë gjykatësve shqiptimin më të lehtë të dënimeve për kryesit e dukurive të tilla.

Megjithëse Qeveria e Kosovës ka paraparë në agjendën e saj legislative për vitin 2011, që në muajin nëntor të miratoj Ligjin për parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar, deri më tani përveç vullnetit deklarativ, nuk është parë asnjë hap në drejtim të fillimit të draftimit të këtij ligji. Ende nuk dihet nëse në kuadër të këtij ligji do të jetë ose jo rregullimi i çështjes së konfiskimit të pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme. Sa i përket kësaj të fundit, edhe Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës do të duhej të plotësohet.

Plotësimi dhe ndryshimi i Kodit Penal, nxjerrja e Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Krimit të Organizuar, si dhe nxjerrja e Ligjit për Konfiskimin e Pasurisë së Fituar në Mënyrë të Paligjshme, do të plotësojnë deri në një masë zinxhirin e legjislacionit kundër krimit të organizuar.

Konventat dhe aktet ndërkombëtare të zbatueshme drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës, që ndikojnë në luftën kundër krimit të organizuar janë: Deklarata universale për të drejtat e njeriut, Konventa evropiane për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe protokollat e saj, Konventa kundër torturës dhe trajtimeve e ndëshkimeve të tjera mizore, jo njerëzore dhe poshtëruese etj.

V. Niveli i krimit të organizuar në Kosovë

Krimi i organizuar konsiderohet si kërcënim ndaj sigurisë kombëtare dhe ndërkombëtare. Ky kërcënim mund të manifestohet në forma të ndryshme, në varësi me zhvillimin e jetës ekonomike dhe shoqërore sidomos në kushtet e globalizimit.³ Niveli i krimit të organizuar në Kosovë është i paqartë dhe shpeshherë mbështetet nga thashethemet në mungesë të informatave lidhur me hetimet, paditë dhe vendimet.

Për më tepër, raportohet se korrupsioni është shumë i përhapur në fusha të ndryshme në Kosovë dhe mbetet një brengë serioze për proceset e shtet-ndërtimit të Kosovës. Raporti i Progresit për Kosovën i vitit 2010 thekson disa nga këto mangësi, duke konkluduar se deklarimi i fundëm i pasurisë së zyrtarëve të lartë në Kosovë ka treguar "...mospërputhje mes të hyrave dhe pronave të zyrtarëve të lartë të Kosovës. Kjo sugjeron se korrupsioni i nivelit të lartë në Kosovë vazhdon të jetë i njëjtë".⁴

Ekziston përceptimi i gjerë i opinionit publik, që zyrtarët e lartë apo bashkëpunëtorët e tyre kanë qenë imun ndaj hetimeve dhe përndjekjeve. Ndërkohë që raporte e ndryshme ndërkombëtare në mënyrë të vazhdueshme kanë vënë në pah mangësitë që rrjedhin nga korniza politike, legjislative dhe institucionale e cila ka nevojë të forcohet më mirë me strukturat shumë-anëshe të cilat kërkojnë mekanizmat më të mirë koordinimi dhe komunikimi. Mungesa e vullnetit politik për tu marrë me korrupsionin dhe krimin e organizuar, apo edhe ndërhyrjet politike në strukturat që merren me korrupsion janë brengosëse.

Ndër format më të shprehura të krimit të organizuar në Kosovë pa mëdyshje se janë narkokriminaliteti (në trajtën e vet më të shpeshtë të kontrabandimit me narkotikë), dhe trafikimi me qenie njerëzore (në trajtën e trafikimit të femrave me qëllim të detyrimit në prostitucion). Edhe raportet e ndryshme regjionale dhe ndërkombëtare mbi Kosovën veqojnë këto dy forma të krimit të organizuar si dy format më fitimprurëse të biznesit të kundërligjshëm kriminal.⁵

5.1 Narkokriminaliteti dhe intenziteti i tij në Kosovë

Varësia nga droga në të vërtetë është një nga fatkeqësitë më serioze që ndonjëherë është katandisur shoqëria. Shtimi i drogave ilegale është bërë një ndër problemet më të mëdha në botë duke përfshirë edhe vendin tonë. Edhe pse, blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike në Kosovë është e sanksionuar me ligj, trafikantët e drogës nuk ndihen aq të rrezikuar sikurse trafikantët e Evropës Perëndimore.

Aktivitetet ekonomike në Kosovë janë në nivel shumë të ulët si pasojë e luftës së fundit në Kosovë ku gati të gjitha fabrikat ishin shkatërruar. Si pasojë e kësaj, shkalla e

³ Strategjia ndërsektoriale e Luftës kundër krimit të organizuar dhe trafikimeve/MPB/2008

⁴ Raporti i Progresit për Kosovën i Komisionit Evropian për vitin 2010.

⁵ PK-ja ka zhvilluar përshkrime pune për menaxhmentin e vet të lartë dhe strukturës së re të policisë që janë miratuar dhe nënshkruar nga Ministri i Punëve të Brendshme pasi që gradimet e brendshme ndodhën. Ibid. 60 Shih fq. 51 të Raportit Vjetor të Gjykatësve të EULEX 2009, në www.eulex-kosovo.eu/docs/justice/annual/

papunësisë është shumë e lartë (mendohet rreth 60 %) dhe shumë ishin joshur nga oferta e lartë e të ardhurave/parat nga grupet e krimit të organizuar duke përfshirë sindikatat e drogës që e gjejnë Kosovën si një vend ideal për të zhvilluar aktivitetet e tyre kriminale.

Një arsye tjetër mund të jetë nga fakti se pas luftës, shumë njerëz që kanë vërshuar Evropën Perëndimore, derisa kanë qenë atje u janë ekspozuar përdorimit të drogave ilegale. Kur janë kthyer në Kosovë, kjo ka vazhduar dhe kanë propaganduar gjerësisht kërkesën, posaçërisht te gjeneratat e reja. Të pasurit në dispozicion narkotikët si dhe çmimet e tyre të ulta, ka ndikuar në problemin e shpërdorimit të drogës.




Tabela Nr 1. Pasqyron rastet e drogës nëpër regjione te Kosovës/Viti 2009 (shënime nga departamenti Antidrogë Policia e Kosovës)




Tabela Nr 2. Konfiskimet e drogës/Viti 2009 (shënime nga departamenti Antidrogë Policia e Kosovës).

5.2 Krimi i organizuar në trajtën e Trafikimit me qenie njerëzore me qëllim të detyrimit në prostitucion

Sipas organizatave që merren me mbrojtjen e viktimave dhe parandalimin e trafikimit me qenie njerëzore, është rritur dukshëm numri i viktimave që shfrytëzohen për qëllime seksuale. Sipas këtyre organizatave, prej vitit 2001 e deri më tani, janë identifikuar afër 600 viktima⁶. Por, për dallim nga vitet e mëparshme, që nga viti 2005, Kosova është shndërruar në vend origjine dhe destinacioni për trafikim të qenieve njerëzore, kështu që është rritur dukshëm numri i viktimave kosovare dhe është zvogëluar numri i viktimave të huaja. Sipas informacioneve të grumbulluara nga trafikimi me qenie njerëzore është ngritur gjatë disa viteve të kaluara. Ndërkohë, Policia e Kosovës ka vlerësuar se viktima të trafikimit janë të gjitha komunitetet. "Që nga viti 2001, kur ne mbajmë statistika për trafikim me qenie njerëzore e deri më sot, ato tregojnë se nëpër vite kemi pasur, përpos shqiptareve, edhe nacionaliteti rom, kroat, serbe, dhe të gjitha komunitetet tjera që jetojnë në Kosovë", është vlerësimi i njërit nga zëdhënësit e Policisë së Kosovës.

"Arsyeja kryesore për trendet e rritjes, qëndrojnë në procesin e tranzicionit, krizës në Kosovë, varfërisë në ngritje dhe shkallëve të papunësisë, rritja e statistikave të krimit të organizuar, si dhe zvogëlimit të kontrollit kufitar në Evropën Qendrore dhe Lindore"⁷, ka thënë Tanja Gjurovska, psikologe pranë SOZM-së.

Gjurovska prezantoi statistikën e fundit që u ofruan në dispozicion nga IOM-i, të cilat tregojnë se 84,13 % të grave të anketuara lanë vendet e tyre për të gjetur punë më të mira, 75.96 janë rekrutuar me premtime të rrejshme për punë të siguruara jashtë vendit, 8.62% ishin kidnapuar, përderisa 6.12 % ishin mashtruar me kontrata të falsifikuara punësimi.

Sipas SOZM-së, popullata rinore është me e prekshme ndaj trafikimit me qenie njerëzore dhe ka nevojë për vetëdijesim mbi këtë problem.

"Viktimat potenciale të hallkave të trafikimit rekrutohen nga radhët e popullatës së re. Andaj, ata kanë nevojë më shumë informacion mbi këtë problem, të arsimohen dhe të krijojnë një sistem mbrojtës të tyre", ka vlerësuar Gjurovska.

Që prej vitit 2004, SOZM zbaton Programin Kundër-Trafikim. Ky program ka për synim arsimimin, veprimet parandaluese, vetëdijesimet e ngritura mbi rrezikun e bërjes viktime. Nën mbikëqyrjen e këtij programi, SOZM zbaton Punëtori Edukative për Parandalim e Trafikimit me Qenie Njerëzore.

Ndërkohë, edhe pse ligji i ndalon të gjitha format e trafikimit të qenieve njerëzore, prapëseprapë, ka pasur raporte sipas të cilave njerëzit janë trafikuar, përmes, brenda dhe nga jashtë vendit. Femrat dhe fëmijët janë trafikuar brenda vendit, kryesisht nga pjesët rurale në baret urbane në pjesën perëndimore të vendit. Shumica e viktimave të trafikuar në vend kanë ardhur nga Serbia, Kosova dhe Shqipëria. Viktimat nga Maqedonia dhe vikti-

⁶ Deklaratë e Tanja Gjurovska, psikologe pranë SOZM-së. Që prej vitit 2004, SOZM zbaton Programin Kundër-Trafikim. Revista shkencore *Kriminalisticke Teme- casopis za kriminalistiku, kriminologiu i sigurnosne studije.

⁷ Deklaratë e Tanja Gjurovska, psikologe pranë SOZM-së. Që prej vitit 2004, SOZM zbaton Programin Kundër-Trafikim. Revista shkencore *Kriminalisticke Teme- casopis za kriminalistiku, kriminologiu i sigurnosne studije

mat që kanë kaluar nëpër Maqedoni janë trafikuar në vendet e Evropës jugore, qendrore dhe perëndimore, përfshirë Greqinë, Bosnjën, Serbinë, Italinë dhe Suedinë. Ka qenë vështirë të merren statistikat zyrtare për fushëveprimin e trafikimit, për shkak se trafikuesit e kanë ndryshuar mënyrën e veprimit. Më pak se 1/3 e të gjitha viktimave potenciale e kanë pranuar ndihmën e ofruar nga qeveria.

VI. Masat e ndërmarra për luftën kundër krimit të organizuar

Pasojat që me vete i sjellë krimi i organizuar në shoqërinë kosovare, duhet kushtuar kujdes të veçantë sidomos nga ana e mekanizmave shtetëror, institucional dhe shoqërorë, duke u angazhuar aktivisht në parandalimin dhe zbulimin e të gjitha formave të krimit të organizuar.

Gjendja aktuale e reagimit gjyqësor dhe prokurorial ndaj krimit të organizuar dhe korrupsionit në Kosovë rrjedh nga struktura gabimisht e planifikuar e UNMIK-ut, e cila deri më 15 qershor 2008 kishte përgjegjësinë e plotë për fushën e krimeve të luftës, krimeve ndëretnike dhe krimit të organizuar, të cilat në mënyrë qenësore kërcënojnë sundimin e ligjit në Kosovë. Dosje të vjetra kanë mjaftuar për të mbajtur Komponentën e Drejtësisë të EULEX-it të zënë gjatë vitit 2009-2010 duke lënë shumë pak hapësirë për procesime të tjera. Nga ana tjetër institucionet vendore kompetente edhe më tutje kanë vazhduar me reagime tejet simbolike në luftën kundër këtyre dukurive.

6.1 Strategjia shtetërore e Kosovës për luftë kundër krimit të organizuar

Pozita gjeostrategjike e Republikës së Kosovës në Ballkan si dhe kushtet e krijuara pas-luftës, u kanë mundësuar grupeve të ndryshme kriminale për të zhvilluar aktivitete të krimit të organizuar. Shkalla e lartë e papunësisë dhe varfëria, gjithashtu kanë kontribuar në krijimin e kushteve të përshtatshme për zhvillimin e krimit në përgjithësi dhe krimit të organizuar në veçanti.

Me qëllim që të ndërmerren masa në parandalimin e paraqitjes së formave të ndryshme të krimit, institucionet shtetërore, përkatësisht Ministria e Punëve të Brendshme, ka përgatitur dokumentin: Strategjia shtetërore e Republikës së Kosovës për parandalimin e dhe Plani i veprimit për periudhën 2009-2012. Kjo strategji është një dokument i cili përcakton synimet, parimet themelore, përcakton objektivat, institucionet përgjegjëse dhe mënyrat për arritjen e suksesit në parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar. Strategjia Kombëtare Kundër Krimit të Organizuar për periudhën 2009-2012, mbështetet në kushtetutën dhe legjislacionin e aplikueshëm në Republikën e Kosovës, instrumentet ligjore ndërkombëtare dhe praktikatat më të mira ndërkombëtare⁸.

Kjo strategji është e strukturuar në mënyrë të tillë që të identifikojë qartë objektivat që duhet të përmbushen në mënyrë që i gjithë mekanizimi institucional të vihet në funksion të parandalimit dhe luftimit me sukses të krimit të organizuar në Kosovë, si dhe duke qenë partnerë me vendet dhe organizatat ndërkombëtare tjera në luftë kundër kësaj dukurie përmes bashkëpunimit ndërkombëtarë. Kjo strategji ndihmon në zhvillimin dhe implementimin e politikave duke forcuar kapacitetet institucionale kundër krimit të organizuar në të gjitha nivelet e organizimit institucional dhe shoqëror.

⁸ Strategjia shtetërore e Republikës së Kosovës Kundër krimit të organizuar dhe plani veprimit 2009-2012/MPB.

6.2 Kompetencat e veçanta të PSRK-së (Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës)

Prokuroria Special e Republikës së Kosovës (PSRK) ka kompetencë të veçantë për hetimin dhe ndjekjen e krimeve, edhe të atyre në formë të tentimit, dhe format e ndryshme të bashkëpunimit. Sipas modaliteteve të përcaktuara në nenin 10 të Ligjit për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës dhe në pajtim me ligjin në fuqi të KPK-së, ZSPK-ja gjithashtu do të ketë kompetencë plotësuese për hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve, edhe të atyre në formë të tentimit, dhe format e ndryshme të bashkëpunimit në krim⁹.

Ushtrimi i kompetencës plotësuese nga PSRK-ja sipas nenit 10.1 të Ligjit për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës, kur është në interes të hetimit a ndjekjes së duhur të krimeve, PSRK-ja do të ushtrojë kompetencën e vet plotësuese lidhur me veprat penale të paraqitura në paragrafët 1 dhe 2 të nenit 9 të këtij ligji¹⁰. Për qëllimet e këtij ligji është në interes të hetimit a ndjekjes së duhur të krimeve të paraqitura në paragrafët 1 dhe 2 të nenit 9 të këtij ligji që çdoherë njëra nga kriteret e caktuara të jenë plotësuar.

VII. Mekanizmat tjerë institucional dhe përgjegjësitë e tyre në luftën kundër krimit të organizuar

Një rol jashtëzakonisht të rëndësishëm me qëllim të koordinimit të aktiviteteve në luftë kundër fenomeneve negative me theks të veçantë krimit të organizuar, kanë edhe mekanizmat tjerë institucional, që aktualisht funksionojnë në vendin tonë.

Sipas Dokumenteve Strategjike, në këtë rast Strategjisë shtetërore e Republikës së Kosovës për parandalimin si dhe Plani i veprimit për periudhën 2009-2012, të miratuara nga institucionet tona ekzekutive, me qëllim të parandalimit dhe luftimit të krimit të organizuar në Republikën e Kosovës, detyrë dhe përgjegjësi i kanë edhe këtyre institucioneve¹¹:

1. Koordinatori Nacional – i cili është organ individual, dhe që ka përgjegjësi të koordinoj, bashkërendoj, monitoroj dhe raportoj lidhur me implementimin e politikave, aktiviteteve dhe veprimeve të parapara në Strategjinë Kundër Krimit të Organizuar.

2. Sekretariati – i cili ka për detyrë që të mbledhë informacionet dhe të dhënat nga institucionet tjera..

3. Ministria e Punëve të Brendshme - MPB-ja, ka rol funksional në arritjen e objektivave të caktuara . Policia e Kosovës si agjencion për zbatimin e ligjit në kuadër të MPB-së, ka përgjegjësinë e plotë në luftimin e të gjitha formave të krimit të organizuar. Policia

⁹ Ligji nr.03/L-052 për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës, si dhe Neni 10 i Rregullores së ndryshuar të UNMIK-ut nr. 2004/2 mbi Pengimin e larjes së parave dhe veprave të ngjashme.

¹⁰ Ligji nr.03/L-052 për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës.

¹¹ Strategjia ndersektorale e Luftës kundër krimit të organizuar dhe trafikimeve/MPB/2008; Strategjia shtetërore e Republikës së Kosovës Kundër krimit të organizuar dhe plani veprimit 2009-2012/MPB.

e Kosovës dhe dogana, së bashku me institucionet tjera janë akter kyç në parandalimin dhe luftimin e aktiviteteve kriminale jo vetëm në kufirin e Kosovës por edhe në gjithë territorin e Kosovës¹².

4. Ministria e Ekonomisë dhe Financave - MEF-i përmes institucioneve të tyre vartëse si: doganat, Qendra e Inteligjencës Financiare dhe Administrata Tatimore, duhet të ndërmarrin veprime të nevojshme me qëllim të parandalimit të qarkullimit ndërkufitarë të mallrave dhe materialeve, mashtrimet dhe transaksionet financiare të cilat kanë të bëjë me të gjitha format e krimit të organizuar. Roli i kësaj ministrie ka të bëjë edhe me ndihmën në identifikimin, raportimin dhe bllokimin e financimit të aktiviteteve që kanë të bëjnë me krimin e organizuar.

5. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë – MTI, luan do të ndërmerrë veprime në identifikimin dhe kontrollimin e subjekteve afariste të cilat dyshohen se merren me veprimtari të paligjshme.

6. Ministria e Drejtësisë – MD, është një nga institucionet më të rëndësishme në luftën isë kundër krimit të organizuar dhe dukurive tjera negative. Ky institucion ka për obligim që të komplotoj legjislacionin në fushën e sundimit të ligjit për të shtuar efikasitetin në realizimin e synimeve strategjike në luftën kundër kriminalitetit lidhur me krimin e organizuar si dhe të sigurojë kushte të nevojshme për institucionet e drejtësisë në këtë rast për prokuroritë e në veçanti për Prokurorinë Speciale, të cilën e konsideron si një institucion kyç në luftimin e krimit të organizuar.

7. Këshilli Gjyqësor i Kosovës – është institucion i cili obligohet të sigurojë pavarësinë e gjykatave në Kosovë, që të jenë profesionale dhe të paanshme, me qëllim që sistemi gjyqësor të jetë më efektiv në luftë kundër krimit të organizuar dhe formave tjera të kriminalitetit.

8. Këshilli Prokurorial i Kosovës - është institucion i cili obligohet të sigurojë pavarësinë sistemi prokurorial në Kosovë, dhe të ofrojë mbështetjen në rritje e profesionalizmit në ushtrimin e ndjekjes , hetimit, dhe zbulimit të veprave penale, të përfaqësojë në gjykata aktet akuzuese në emër të shtetit.

9. Prokuroritë dhe Gjykatat - janë institucionet përgjegjëse për ndjekjen penale të kryesve ndëshkimin adekuat të tyre, për konfiskimin e pasurisë dhe aseteve të fituara me anë të aktiviteteve kriminale. Në kuadrin institucional, një rol të rëndësishëm për parandalim dhe luftim të krimit të organizuar luajnë edhe institucionet tjera vendore dhe institucionet ndërkombëtare partnere prezente në Kosovë por edhe jashtë saj¹³.

10. Agjencia Kosovare për Inteligjencë - është organ shumë i rëndësishëm në luftën kundër krimit të organizuar, i cili mbledhë, vlerëson dhe përcjell informacione në lidhje me kërcënimet nga aktivitetet e krimit të organizuar ndaj sigurisë së Kosovës.

¹² Strategjisë shtetërore e Republikës së Kosovës për parandalimin si dhe Plani i veprimit për periudhën 2009-2012. http://www.mpb-ks.org/repository/docs/STRATEGJIA_KKT_30_QERSHOR_Alb.pdf

¹³ Strategjisë shtetërore e Republikës së Kosovës për parandalimin si dhe Plani i veprimit për periudhën 2009-2012. http://www.mpb-ks.org/repository/docs/STRATEGJIA_KKT_30_QERSHOR_Alb.pdf

11. Agjencioni Kosovar kundër Korrupsionit – Ky Agjencion është organ i pavarur dhe i specializuar për zbatimin e politikave shtetërore për luftimin dhe parandalimin e korrupsionit në Kosovë¹⁴. Ai inicion dhe zhvillon procedurën e zbulimit dhe hetimit paraprak të korrupsionit dhe përcjellë kallëzime penale për rastet e dyshimit për korrupsion në prokurorinë publike kompetente, nëse për të njëjtin rast nuk zhvillohet procedurë penale¹⁵.

Institucionet tjera që kanë rol dhe kompetencë në luftën kundër krimit të organizuar janë edhe këto dikastere të qeverisë: Ministria e Punëve të Jashtme (MPJ), Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (MASH), Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve (MKRS), Ministria e Shëndetësisë (MSh), Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), dhe Ministria e Transport dhe Postë - Telekomunikacionit (MTPT).

VIII. Konfiskimi i dobive pasurore të fituara nga aktivitetet e paligjshme

Konfiskimi i pasurisë e cila është fituar në mënyrë të paligjshme, është një nga masat kryesore dhe shumë të rëndësishme në rritjen e efikasitetit në luftën kundër krimit të organizuar dhe individëve, me theks të veçantë zyrtarëve të lartë publik, të cilët brenda një periudhe shumë të shkurtër realizojnë pasuri me qindra, mijëra e miliona euro.

Legjislacioni i aplikueshëm në Kosovë, ka përcaktuar masat e sekuestrimit dhe të konfiskimit të dobive pasurore ndaj të gjithë atyre që fitimin e dobisë pasurore e kanë nga aktivitetet kriminale. Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës, kreu i VII-të për Konfiskimin e Dobisë Pasurore të fituar me anë të kryerjes së veprës penale dhe arsye për Konfiskimin e Dobisë Pasurore, parashih konfiskimin e pasurisë së paligjshme në nenin 82, paragrafi 1 dhe 2¹⁶.

Paratë apo prona që është e fituar përmes veprave kriminale sipas ligjit të zbatueshëm kosovar mund të konfiskohet ose përmes një vendimi gjyqësor që vërteton kryerjen e veprës penale ose me kërkesë të prokurorit publik para një paneli, (Kodi i Procedurave Penale i Kosovës, Neni 498)¹⁷. Policia dhe autoritetet tjera po ashtu mund të marrin pjesë në hetimin e rrethanave që mund të determinojnë përfitimet nga krimi i kryer. Paratë ose prona që është dhënë, pranuar ose përfituar përmes kryerjes së një akti kriminal, për shembull pranimi i paarsyetuar i dhuratave, marrja apo dhënia e mitos dhe tregtimi me ndikim me vendimmarrje të një personi zyrtar, gjithashtu duhet të konfiskohen. Nëse përfitimet nga akti kriminal u transferohen kushërinjëve të afërt, edhe ato duhet të konfiskohen¹⁸.

¹⁴ Ligji për Agjencinë Kundër Korrupsionit, neni 3.

<http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2009-159-alb.pdf>

¹⁵ Ligji për Agjencinë Kundër Korrupsionit, neni 4.

<http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2009-159-alb.pdf>

¹⁶ Kodi i përkohshëm Penal i Kosovës (KPPK), kreu I VII-të Konfiskimin e Dobisë Pasurore Siguruar nga Realizimi i Veprave Penale dhe arsye për Konfiskimin e Dobisë Pasurore, Neni 82, paragrafi 1 dhe 2.

¹⁷ Kodi i përkohshëm i Procedurës Penale i Kosovës (KPPPK) – neni 498

¹⁸ Kodi i përkohshëm Penal i Kosovës (KPPK) Neni 83.

Gjendja reale në teren, na dëshmon se këto masa nuk janë përdorur në asnjërën nga rastet nën hetim apo në gjykata, as nga institucionet gjyqësore vendore e as nga ato të EULEX-it. Vlerësimi i prokurorëve është se se gjykatësit ngurrojnë t'i zbatojnë këto masa për shkak të kërcënimeve të mundshme të sigurisë që mund t'u ndodhin dhe për shkak të mungesës së interesimit, përderisa gjyqtarët vlerësojnë se prokurorët nuk ua propozojnë këto masa, mu për arsye të ngjashme. Mungesa e një ligji të veçantë mbi konfiskimin e pronës së fituar në mënyrë të paligjshme, shpesh është përmendur si arsye për hezitim të gjykatave të zbatojnë masa të tilla. Me qëllim të rritjes së efikasitetit në luftë kundër këtyre fenomeneve, përveq nevojës për draftim të ligjeve të reja, është më se e nevojshme të fuqizohen kapacitetet e gjykatave dhe të prokurorëve me qëllim që të punojnë në konfiskimin e pasurive të kriminelëve të gjykuar, apo të kriminelëve të akuzuar në momentin që hetimi dhe përndjekja e rasteve të korrupsionit fillon.

Po ashtu edhe sa i përket dhuratave të zyrtarëve të lartë publik, kjo duket se nuk është praktikuar deri tash nga institucionet kosovare apo misioni i EULEX-it. Konfiskimi i dobive pasurore të fituara nga kryerja e veprave penale duhet të shihet si një masë ndëshkuese për të siguruar që pasuritë e përfituara janë arritur nga kryerja e akteve kriminale.

Edhe pse në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë, momentalisht është funksionale një strukturë organizative e Agjencisë që është përgjegjëse për menaxhimin e aseteve të konfiskuara dhe të sekuestruar, e cila bazë legale ka Ligjin për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar, megjithatë ky Agjencion ka për kompetencë vetëm administrimin profesional të pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar, dhe jo nxjerrjen e vendimit mbi konfiskimin apo sekuestrimin e pasurisë së caktuar, në këtë rast pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme.

Detyrat dhe përgjegjësitë e Agjencionit janë që të ruan dhe administron pasurinë e sekuestruar ose të konfiskuar në bashkëpunim me prokurorinë, gjykatën, apo organet tjera kompetente, në pajtim me ligjin në fuqi, me përjashtim të pasurisë së konfiskuar për realizimin dhe mbledhjen e detyrimeve tatimore. Ndihmon në ekzekutimin e vendimeve për sekuestrimin ose konfiskimin e pasurisë. Sipas kërkesës së organeve kompetente mundëson shitjen e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar, sipas autorizimit të organit kompetent angazhon ekspert sipas nevojës për vlerësimin e vlerës së pasurisë dhe mënyrën e ruajtjes së sendit të sekuestruar ose të konfiskuar¹⁹.

Agjensioni, administrimin e të dhënave lidhur me pasurinë e sekuestruar ose të konfiskuar e bënë sipas nenit 6 (Ligji Nr. 03/ L-141)²⁰. Në kuptimin e këtij ligji "Konfiskimi" do të thotë marrje e përhershme e sendit në bazë të vendimit të formës së prerë të gjykatës kompetente, apo organit tjetër kompetent, në pajtim me ligjin në fuqi, "Organ kompetent" nënkupton çdo organ apo institucion që në të bazë të ligjit në fuqi është i autorizuar të bëjë sekuestrimin ose konfiskimin e pasurisë. "Pasuri të Sekuestruara ose të Konfiskuara" konsiderohen sendet luajtshme, sendet e paluajtshme, paratë dhe letrat me vlerë të cilat janë në qarkullim juridik; "Sekuestrim" do të thotë marrja e përkohshme e sendit në bazë të vendimit të gjykatës apo organit kompetent, në pajtim me ligjin në fuqi²¹.

¹⁹ Ligji për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar, Nr. 03/ L-141

²⁰ Ligji për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar Nr. 03/ L-141

²¹ Ligji për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar Nr. 03/ L-141

Thelbi i këtij veprimi kriminal qëndron në synimin e pronarëve të këtyre mjeteve monetare apo pasurive të fituara në rrugë kriminale për të krijuar kushte, nëpërmjet veprimtarisë së kundërligjshme, që t'i gëzojnë ato sikur të ishin përfitime të ligjshme. Për këtë qëllim ata përdorin mjete dhe metoda nga më të ndryshmet, ku veçojmë teknikat e futjes në qarkullim dhe riqarkullimin e parave që kanë rrjedhur nga veprimtaria kriminale. Legalizimi i mjeteve monetare dhe i pasurisë së fituar në rrugë të paligjshme realizohet nëpërmjet veprimeve të tilla, si: Depozitimi, tjetërsimi, transferimi ose këmbimi i parave me qëllim maskimin, fshehjen ose mohimin e përkatësisë apo origjinës së pasurisë që rrjedh nga veprimtaria kriminale.

Përkundër që raportet e ndryshme vendore dhe ndërkombëtare flasin për prezencë të madhe të paraqitjes së këtyre fenomeneve, fatkeqësisht veprimet e institucioneve kompetentë për ti parandaluar ato janë minimale.

IX. Veprimet e institucioneve në luftën kundër krimit të organizuar dhe pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme

9.1 Sfidat në implementimin e kompetencave të institucioneve

Zbatimi i ligjit në Kosovë në fushën e parandalimit dhe luftimit të krimit të organizuar është i fragmentuar, i mungon koordinimi dhe bashkëpunimi efikas ndërinstytucional, si dhe bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar, parakushte këto themelore për sukses në luftimin e kësaj dukurie²².

Policia e Kosovës ende nuk ka arritur në krijimin e kapaciteteve të nevojshme për koordinimin e brendshëm për menaxhimin e informacionit dhe inteligjencës. Njësitë e nivelit lokal të inteligjencës nuk udhëhiqen nga Drejtoria për Inteligjencë dhe Analizë të Krimit, dhe si pasojë puna policore dominohet nga kontrolli lokal dhe bashkëpunimi minimal brenda organizatës. Për më shumë, nuk ka shkëmbim efikas të informacioneve në mes të njësive qendrore që merren me luftimin e krimit të organizuar dhe drejtorisë për analizë të krimit²³.

Për shkak të situatës të përshkruar më lart, drejtoria për analizë të krimit nuk e influencon procesin e marrjes së vendimeve strategjike në lidhje me menaxhimin e informatave dhe luftimin e krimit të organizuar, prandaj duket qartë se nevojitet një organizim më i mirë i një modeli kombëtar për të siguruar shkëmbimin efikas të informatave brenda njësive policore²⁴.

Agjensionet për zbatim të ligjit, sidomos Policia e Kosovës dhe Dogana, duhet t'i zhvillojnë kapacitetet për mbledhje dhe shkëmbim të informatave duke ndërtuar një sistem institucional.

²² (revista shkencore/sarajevo/kriminalisticke teme pa.4)

²³ ASKK-Friga nga kriminalisteti dhe kordinimi institucional, vetparaqitje e devijimit 2009/pr010.

²⁴ <http://www.eulex-kosovo.eu/docs/justice/annual> - Raporti i parë i EULEX-it për situatën në polici, gjykata dhe burgje.

Po ashtu, ka mungesë bashkëpunimi në nivel ndërkombëtar. Kjo më së shumti reflektohet në vështirësitë për implementimin e programeve rajonale për shkak të mungesës së bashkëpunimit të disa shteteve me institucionet e Kosovës. Në Policinë e Kosovës ka mungesë të personelit të trajnuar dhe të specializuar në fushën e forenzikës kompjuterike, përgjimit ligjor, krimit kompjuterik, pastrimit të parave, terrorizmit, dhe fushave tjera të specializuara²⁵.

Numri i prokurorëve të specializuar (me trajnim adekuat) dhe të dedikuar për hetimet kriminale në lidhje me krimin e organizuar dhe Pastrimin e parave nuk është i mjaftueshëm.

Institucionet përgjegjëse për parandalim dhe luftim e krimit të organizuar kanë mungesë të pajisjeve të nevojshme teknike dhe teknologjisë informative, si dhe niveli i ulët i mirëqenies së personelit, gjithashtu ndikon negativisht në efikasitetin e institucioneve përgjegjëse për luftimin e krimit të organizuar, citohet në raportin e EULEX-it²⁶.

Inteligjenca/informacioni, janë parakusht për çfarëdo suksesi në hetime. Në këtë kuptim ka mungesë të implementimit të konceptit policia e udhëhequr nga inteligjenca, si dhe financim të nevojshëm për operacione të fshehta dhe trajtim adekuat të informatorëve.

Mirëmbajtja joadekuate, qasja e kufizuar si dhe mungesa e një sistemi të integruar të bazave të të dhënave, është pengesë për zhvillimin dhe dokumentimin e hetimeve. Angazhimi i institucioneve të Republikës së Kosovës për përmirësimin e situatës së pasqyruar më lartë krijon kushte për luftë efektive dhe të suksesshme kundër krimit të organizuar²⁷.

Strategjia shtetërore e Kosovës për luftë kundër krimit të organizuar, krijon mundësi reale për institucionet e zbatimit të ligjit që në mënyrë efektive dhe efikase, të parandalojnë dhe luftojnë krimin e organizuar.

Policia ka strukturë gjithëpërfshirëse ligjore, ekziston një shqetësim lidhur me cilësinë e udhëheqjes së saj dhe kapacitetit për drejtim strategjik dhe këto karakteristika janë me rëndësi vendimtare për suksesin e Policisë në përballjen me sfidat e paraqitura nga krimi i organizuar dhe Pasuria e pa ligjshme.

Nuk është gjetur asnjë dëshmi se personeli i lartë komandues i PK-së është duke e zhvilluar një strategji gjithëpërfshirëse.

Në mbarë Policinë pranohet nevoja për ta zhvilluar plotësisht programin e kryerjes së detyrave policore të bazuara në inteligjencë, dhe EULEX-i rekomandon me vendosmëri që ky program duhet të jetë në mesin e prioriteteve kryesore të komandantëve të lartë të PK-së gjatë tri viteve të ardhshme.

²⁵ (Raporti i parë i EULEX-it për situatën në polici, gjykata dhe burgje.2010)

²⁶ (Raporti i parë i EULEX-it për situatën në polici, gjykata dhe burgje.2010)

²⁷ (Raporti i parë i EULEX-it për situatën në polici, gjykata dhe burgje.2010)

Policia kufitare ka potencial të bëhet një komponentë shumë e rëndësishme në sistemin e vetëm të inteligjencës: të dhënat lidhur me lëvizjen e personave dhe automjeteve të caktuara nëpër kufijtë e Kosovës janë me rëndësi themelore në luftimin e krimeve të rënda dhe krimin e organizuar.

Drejtorja për Analizë të Krimeve (DAK) mbetet e papërfunduar sa i përket strukturës së personelit dhe udhëheqësisë, duke e privuar PK-në nga mundësia që ta ketë një qendër efikase të sistemit të saj të inteligjencës kriminale. DAK duhet të jetë në qendër të një përpjekjeje të përbashkët për të zhvilluar plotësisht mandatin, strukturën dhe kapacitetin e vet dhe duhet lejuar ta marrë rolin udhëheqës në lëvizjen drejt kryerjes së detyrave policore të 'bazura në inteligjencë'²⁸.

Drejtorisë për Krimin e Organizuar (DKO) i mungon një dokument i hollësishëm strategjik që i përkufizon qëllimet dhe objektivat e saj dhe, si rrjedhojë, nuk ekziston ndonjë politikë e shkruar ose strategji e përgjithshme që i jep formë përpjekjes për t'u marrë me krimin e organizuar. Po ashtu ekziston nevoja që të shtohet në masë të madhe shfrytëzimi i statistikave për llojet e krimeve të kryera dhe informatave të inteligjencës gjatë planifikimit të aktiviteteve të DKO-së.

9.2 Veprimet që duhet ndërmerren nga institucionet kompetente në luftë kundër krimit të organizuar

9.2.a. Policia

Institucioni i Policisë duhet ta zhvillojë një strategji të sofistikuar dhe efikase për emigrantët e paligjshëm, si pjesë e zhvillimit të Menaxhimit të Integruar të Kufijve (MIK). Gjatë zhvillimit drejt MIK, Policia duhet të punojë me doganat, prokurorinë dhe EULEX-in për të nxjerr një strategji për krimet ndërkufitare. Komunikimi dhe rrjedha e informatave - si ndërmjet pjesëve të ndryshme të policisë kufitare ashtu edhe ndërmjet kësaj shtylle dhe pjesëve të tjera të PK-së - mbesin e metë themelore. Kjo e metë ka ndikim dobësues në funksionimin e policisë kufitare dhe në efikasitetin e saj për arritjen e objektivave²⁹.

Bashkëpunimi i ngushtë ndërmjet prokurorëve publik dhe hetuesve të Policisë, që parashihet me ligj shpesh mungon në praktikë dhe është një tregues esencial se duhet të funksionalizohet Policia Gjygsore, e cila në vete duhet të ketë staf akademik adekuat të specializuar në të gjitha fushat e luftimit dhe parandalimit të krimit të organizuar. Rekomandohet që zyrtarët e lartë të Policisë dhe Prokuroria Publike (PP) të fillojnë një përpjekje të përbashkët për t'i hulumtuar mënyrat që do t'u mundësonin prokurorëve dhe hetuesve të bashkëpunojnë më ngushtë në përpjekje ekipore³⁰. Po ashtu, ka shqetësim lidhur me menaxhimin e funksioneve të caktuara mbështetëse

²⁸ (Raporti i parë i EULEX-it për situatën në polici, gjykata dhe burgje.2010)

²⁹ <http://www.eulex-kosovo.eu/docs/justice/annual>

³⁰ (Raporti i parë i EULEX-it për situatën në polici, gjykata dhe burgje.2010/
<http://www.eulex-kosovo.eu/docs/justice/annual>)

në kuadër të shtyllës së operacioneve. Ekziston mungesë e llogaridhënies lidhur me vlerësimin statistikor të kryerjes së punës nga ana e njërive (p.sh. Njësia Speciale për Hetime dhe ajo për shkatërrimin e mjeteve shpërthyes (I/EOD)) të cilat nuk janë në gjendje të ofrojnë të dhëna të hollësishme statistikore për numrin e incidenteve me të cilat janë marrë³¹.

9.2.b. Drejtësia

Në krahasim me Policinë, sistemi i drejtësisë si tërësi është treguar shumë i dobët në aftësinë e tij për të mbështetur një ndjekje dhe gjykim të pavarur dhe efikas të rasteve. Të gjeturat tregojnë se mekanizmat llogaridhënës sipas ligjit për luftimin e korrupsionit janë funksional. Sipas hetimeve të bëra nga kryesuesi i Agjencisë Anti-Korrupsion (AAK), është dëshmuar se mekanizmi për verifikimin e nivelit të deklarimit të pasurisë nga ana e gjyqtarëve të Kosovës është funksional. Agjencia Anti-Korrupsion ka raportuar për një numër rastesh të tilla. Prokurorët e EULEX-it dhe AAK-ja kanë nënshkruar një memorandum mirëkuptimi sa i përket bashkëpunimit në këtë fushë.

Të gjeturat e EULEX-it kanë zbuluar dobësi në lidhje me pavarësinë de jure të gjyqësisë kosovare. Me gjithë pavarësinë që kanë, de facto, janë identifikuar të meta sa i përket sigurisë së gjyqtarëve kosovar. Nuk ka ndonjë sistem për mbrojtjen e gjyqtarëve kosovarë në gjykatë, jashtë saj dhe pas orarit të punës. Është shënuar po ashtu edhe mungesë masash për garantimin e sigurisë së prokurorëve kosovarë. Disa incidente të raportuara tregojnë nivelin e trysnisë së jashtme ndaj së cilës janë të ekspozuar prokurorët kosovar; nuk ka as zgjidhje ad-hoc as mekanizma institucional për përcjelljen e incidenteve të tilla³².

Nga ana tjetër, tek misioni i EULEX-it janë vërejtur edhe raste të frikësimit të gjyqtarëve, po ashtu këtyre trysnive u janë ekspozuar edhe prokurorët. Vlerësohet nevoja për trajnime të vazhdueshme për anëtarët e stafit të Departamentit për Çështje Ligjore; për më tepër, përpjekjet e identifikuar për ngritjen e kapaciteteve duket se lëngojnë nga lëvizjet e vazhdueshme të stafit brenda ministrisë³³.

9.2.c. Doganat

Legjislacioni i ri primar që rregullon funksionimin e doganave është i pranishëm që nga hyrja në fuqi në fund të vitit 2008 të Ligjit mbi Doganat dhe Kodin e Akcizës të Kosovës. Ky kod është në harmoni me standardet e BE-së sepse është i bazuar nga Kodi i Bashkimit Evropian për Dogana.

³¹ Raporti i parë i EULEX-it për situatën në polici, gjykata dhe burgje.2010/ <http://www.eulex-kosovo.eu/docs/justice/annual>

³² (Raporti i parë i EULEX-it për situatën në polici, gjykata dhe burgje.2010/ <http://www.eulex-kosovo.eu/docs/justice/annual>

³³ Raporti i parë i EULEX-it për situatën në polici, gjykata dhe burgje.2010/ <http://www.eulex-kosovo.eu/docs/justice/annual>

Legjislacioni sekondar, p.sh. Udhëzimi Administrativ me dispozitat zbatuese dhe udhëzimet pasuese nga ministri i ekonomisë dhe i financave ende nuk janë nxjerrë. Ndonëse nuk është dhënë ndonjë afat për këtë proces, zbrastitë ligjore janë reduktuar në masë të madhe me zbatimin e rregullave dhe të rregulloreve të mëparshme të UNMIK-ut. Garantimi i interpretimit të saktë dhe aplikimi i njëjtë i rregullave doganore që janë në pajtueshmëri me praktikën evropiane, është një sfidë e vazhdueshme.

Bordi i pavarur për shqyrtim, si organi kryesor ku mund të parashtrohen ankesat lidhur me vendimet e Doganave të Kosovës (DK), pas një ndërprerjeje prej dymbëdhjetë muajve, ka filluar të organizojë prapë seanca dëgjimore. Raportimi i brendshëm lidhur me shkeljen e kodit të sjelljes duket të jetë themeluar mirë në kuadër të DK-së. DK-ja ka plan veprimi për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit, po ashtu ekzistojnë edhe masa proaktive.

Plani trajnues i doganave të Kosovës përfshinë pjesën hyrëse, profesionale dhe teknike, por fusha më specifike siç është ajo e zbatimit të ligjit dhe e parandalimit nuk janë të përfshira gjerësisht. Korniza Strategjike e Operimit 2009-2011 nuk paralajmëron ndonjë ndryshim në objektivat gjithëpërfshirëse të doganave të Kosovës. Megjithatë, në planet operative krimi i organizuar përmendet pak.

Megjithëse ekzistojnë funksionet për hetime dhe zbatim, një rishikim i profileve ekzistuese të rrezikut do të ishte i nevojshëm, e po ashtu edhe analizimi i procesit të rrezikut. Nuk ekziston ndonjë sistem i posaçëm informues që i dedikohet krimit të organizuar. Përhapja e informatave nga zbulimi dhe shkëmbimi i të dhënave ndërmjet Drejtorisë për zbatimin e ligjit dhe të asaj për operacionet e të hyrave në kuadër të Doganës së Kosovës duket të jenë mjaft të kufizuara.

Bashkëpunimi dhe shkëmbimi i informatave me agjencitë tjera për zbatimin e ligjit në përgjithësi është i kufizuar, ndonëse në nivel vendor është realizuar një nivel bashkëpunimi p.sh mes Policisë Kufitare dhe Doganave³⁴.

Strategjia për Menaxhimin e Integruar të Kufijve do të rrisë bashkëpunimin në mes të Policisë dhe të Doganave në masë të konsiderueshme në pikat e vendkalimeve kufitare. Ajo do t'i qartësojë mekanizmat për ushtrimin e kontrollit dhe përgjegjësitë dhe do ta intensifikojë kontrollin në kufij për ta parandaluar dhe zbuluar krimin ndërkufitar. Ajo gjithashtu hapë mundësitë për procedura të veprimit të përbashkët dhe plane emergjente me agjencitë e tjera për shërbim/zbatim të ligjit në rajon.

³⁴ (Raporti i parë i EULEX-it për situatën në polici, gjykata dhe burgje.2010/
<http://www.eulex-kosovo.eu/docs/justice/annual>

³⁵ (Raporti i parë i EULEX-it për situatën në polici, gjykata dhe burgje.2010/
<http://www.eulex-kosovo.eu/docs/justice/annual>

9.2.d. Shoqëria civile

24

Sa i përket rolit të shoqërisë civile, kjo më shumë është lidhur me profilin e organizatave joqeveritare. Në janar 2009, 4952 organizata janë regjistruar në Ministrinë e Shërbimeve Publike (MSHP); autoritetet kanë raportuar një trend të njëtrajtshëm të 20 aplikantëve të rinj në javë³⁵.

Të priturat/konstatimet lidhur me EULEX-in, të cilat janë mbledhur gjatë takimeve me OSHC-të/ OJQ-të vendore mund të përmbledhen si vijon:

Shumica dërmuese e OSHC/OJQve, e konsiderojnë luftimin e korrupsionit si prioritet numër një. Një numër i organizatave të OSHC/OJQ-ve filluan të kërkojnë shpjegime nga autoritetet lokale lidhur me shkallën e lartë të korrupsionit mirëpo gjendja ende konsiderohet të jetë larg asaj së pranueshmes. Korrupcioni dhe krimi i organizuar duket të jenë çështje më urgjente në krahasim me trajtimin e krimeve të luftës apo pajtimit ndëretnik.

Disa OSHC/OJQ bëjnë monitorim të gjykimeve dhe atë zakonisht në raste specifike. Përpyekja kryesore për ta ofruar një pasqyrë gjithëpërfshirëse mbi funksionin e gjykatave, ka të bëjë me raportin e kryer nga Rrjeti Ballkanit për Gazetari Hulumtuese (BIRN), duke përfshirë këtu edhe një vlerësim të publikuar në qershor 2009 mbi përafërsisht 600 raste në 6 gjykata komunale në Kosovë. OSHC/OJQ-të janë në favor të luftimit të korrupsionit, i cili konsiderohet të jetë pengesa kryesore në kryerjen e punës si duhet nga ana e institucioneve kosovare. Organizatat si Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), pastaj “Lëvizja Fol e “Qohu!”, kanë ndërmarrë fushata të ndryshme kundër korrupsionit dhe kanë monitoruar veprime të caktuara të kundërligjshme.

Përpyekjet institucionale kundër korrupsionit konsiderohen si të pamjaftueshme dhe shpesh me qëllim të fshehjes së përvetësimeve të mirëfillta nga opinioni publik. Transparenca e të hyrave të zyrtarëve të zgjedhur, financimi i partive politike, marrëdhëniet në mes të menaxhmentit të kompanive private dhe të atyre publike dhe politikës tërheqin vëmendjen e monitoruesve të shumtë nga shoqëria civile dhe këto raporte shpesh mund të gjenden të publikuara nëpër faqet e internetit të OSHC/OJQ-ve të shumta.

Çështja e personave të pagjetur dhe të drejtave pronësore janë identifikuar të jenë fushat me interes me të cilat duhet të merret misioni.

X. Rekomandime

- Është i nevojshëm plotësimi i infrastrukturës ligjore për të parandaluar dhe luftuar me sukses krimin e organizuar dhe pasurinë e fituar në mënyrë të paligjshme. Kjo bëhet përmes ndërtimit të infrastrukturës së përshtatshme ligjore e cila iu mundëson institucioneve përgjegjëse për të zhvilluar aktivitetet.
- Institucionet kompetente duhet të kenë fokus të veçantë nxjerrjen e ligjiit për luftimin e krimit të organizuar dhe atij për konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme.
- Për të luftuar me sukses krimin e organizuar, është e domosdoshme që institucionet përgjegjëse të kenë kapacitetet e mjaftueshme njerëzore të aftësuara dhe të specializuara për luftë efikase kundër krimit të organizuar. Për shkak të kompleksitetit që ka krimi i organizuar është shumë e rëndësishme që strukturat që merren me parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar të kenë mjetet teknike dhe teknologjinë bashkëkohore dhe të standardizuar.
- Është e nevojshme zhvillimi e teknologjisë aktuale si dhe pajisjen me mjete të nevojshme teknike dhe teknologjisë informative, për të arrit qëllimin e luftimit dhe parandalimit të krimit të organizuar dhe pasurimit në mënyrë të paligjshme.
- Duhet funksionalizohen instrumentet e monitorimit dhe vlerësimit si: Sistemin e standardizuar të mbledhjes dhe përpunimit të informacionit; Të dhënat administrative, statistikore të MPB-së (Policisë), MD, MSH, MEF (Dogana, ATK), MASHT, Prokurorisë, Gjykatave, MPMS; Anketime dhe vrojtime të popullatës mbi shkallën e vetëdijesimit për çështjet kundër krimit të organizuar dhe ngitjes së vetëdijes për mënyrat e fitimit të pasurisë në mënyrë të paligjshme.
- Institucionet kompetente ndjekëse si dhe misioni i EULEX-it në Kosovë duhet të japin rezultate të menjëhershme në përndjekjen e rasteve të korrupsionit politik. Kjo do të dërgonte një sinjal të fortë autoriteteve të zgjedhura dhe do rriste vullnetin e përgjithshëm politik të institucioneve të Kosovës në përkrahjen e luftimit të korrupsionit dhe krimit të organizuar.
- Institucionet kompetente duhet marrin masa preventive në parandalimin e krimit të organizuar në të gjitha format që paraqitet ai dhe minimizim i veprave penale që lidhen me krimin e organizuar e trafiket e paligjshme, si dhe luftën kundër korrupsionit, duke arritur në standardet e vendeve më të zhvilluara.

Burimet

26

Raporti i Komisionit Evropian “Kosovo under UN SCR 1244/99 2010 Progress Report” (Nëntor 2010)

<http://www.ico-kos.org/pdf/presseng28.pdf> dhe “Comprehensive Status Proposal”.

<http://www.eusrinkosovo.eu/d/LexUriServ11082010.pdf>

<http://www.eulex-kosovo.eu/en/info/ehatisEulex.php>

Raporti i Programit të EULEX 2009

Strategjia dhe Planin e Veprimit kundër Korrupsionit

Ligji për Ndryshimin dhe Përmirësimin e Ligjit Nr. 02/L-133 mbi Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik dhe Ligji mbi Deklarimin e Prejardhjes së Pronës dhe Dhuratave për Zyrtarë të Lartë Publik.

Intervistë e Tanja Gjurovska, psikologe pranë SOZM-së. Që prej vitit 2004, SOZM zbaton Programin Kundër-Trafikim.

Kodi Penal i Kosovës

Strategjia ndersektoriale e Luftës kundër krimit të organizuar dhe trafikimeve/MPB/2008

Strategjia shtetërore e Republikës së Kosovës Kundër Krimit të Organizuar dhe Plani Veprimit 2009-2012/MPB

<http://www.eulex-kosovo.eu/docs/justice/annual>, raporti i parë i EULEX-it

Raporti HR i Departamentit Shtetëror të SHBA-së, 2008

“Sundimi i Ligjit në Kosovën e pas-Pavarësisë” ICG, Korrik 2010

Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, Neni 498

Ligji nr.03/L-052 për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës

Ligji nr.03/L-053 për Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë

Ligji nr.03/L-159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit

Lilgji nr.03/L-151 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik

Ligji nr.03/L-199 për Gjykatat

Ligji nr.03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës

Ligji nr.03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës

Ligji nr.03/L-225 për Prokurorin e Shtetit

Ligji nr.2004/34 Kundër Korrupsionit

Ligji nr.03/L-155 për Ndryshimin dhe Plotësimin e ligjit nr.02/L-133 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik

Balkan Insight, nga Artan Haraqija, 'Jessen-Petersen: 'Unë jam ndaluar që të hetoj korrupsionin', qershor 2010

Këshilli i Evropës: Komiteti i Ministrave, 'Rekomandimi Rec(2000)19 i Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare për Rolin e Prokurorisë Publike në Sistemin Gjyqësor Kriminal', tetor 2000

'Raporti vjetor 2009 mbi Aktivitetet Gjyqësore të Gjyqtarëve të EULEX-it', 2010

Forumi për Iniciativë Qytetare dhe Instituti i Kosovës për Drejtësi, 'Sundimi i Ligjit: kapacitetet dhe funksionimi institucional', nëntor 2010

Grupi Ndërkombëtar i Krizave (GKN), 'Sundimi i Ligjit në Kosovën e Pas-pavarësisë', korrik 2010

Korporata e Financave Ndërkombëtare dhe Banka Botërore, 'Bërja e biznesit: Matja e Rregulloreve të Biznesit', 2010

'Trekëndëshi i Brishtë: Koordinimi i Policisë, Gjyqtarëve dhe Prokurorëve gjatë procedurës penale në Kosovë', Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave (KIPRED), shkurt 2010.

Ministria e Drejtësisë, nga Sahit Shala dhe Nexhat Haziri, 'Raporti i punës të Prokurorisë Publike në Republikën e Kosovës: 2009', prill 2010

'Raporti mbi Resurset Njerëzore të Prokurorisë Publike në Republikën e Kosovës

Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik, 'Të sigurohemi se shtetet e brishta nuk lihen prapa', 2007

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, 'Seksioni i Monitorimit të Sistemit të Drejtësisë Raporti Mujor – qershor 2009', shtator 2009

Departamenti i Shtetit Amerikan, 'Raporti për të Drejtat e Njeriut 2008: Kosova', shkurt 2009

‘Deklaratë për Klimën e Investimeve 2009 – Kosova’, shkurt 2009

‘Raporti për Trafikimin e Personave’, qershor 2010

Kombet e Bashkuara Programi për Zhvillim, ‘Raporti i Paralajmërimit të hershëm’, përgjatë 2010

UNMIK, Kodi Penal i Kosovës, Rregullorja e UNMIK-ut 2003/25 e plotësuar dhe ndryshuar nga Kuvendi i Kosovës më 6 nëntor 2008

Kodi i Procedurës Penale, Rregullorja e UNMIK-ut 2003/26 e plotësuar dhe ndryshuar nga Kuvendi i Kosovës më 6 nëntor 2008



British Embassy
Pristina

The opinions expressed herein are those of the author. This publication was made possible through support provided by:
Mendimet e shprehura në tekst janë të autorit. Ky publikim është bërë i mundur nga përkrahja e ofruar prej: